

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim: “Për miratimin e sasisë së fletëve të votimit që do të prodhohen për çdo Qendër Votimi për zgjedhjet e për Kryetar të Bashkisë Himarë, Qarku Vlorë, të datës 4 gusht 2024”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Znj. M. Koja, znj. D. Alimemeti, z. E. Meta.
- Parti Politike:** S’ka prezent!
- Të tjerë:** KRIIK

**Z. I. Celibashi:** Mirëmëngjes! Në seancën e sotme kemi në rend dite katër çështje: Projektvendimi “Për miratimin e sasisë së fletëve të votimit që do të prodhohen për çdo Qendër Votimi për zgjedhjet e për Kryetar të Bashkisë Himarë, Qarku Vlorë, të datës 4 gusht 2024”.

Projektvendimi “Për përcaktimin e masës së shpërblimit për operatorët teknikë për përdorimin e kamerës së vëzhgimit në qendrën e votimit”.

Projektvendimi “Për caktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të Komisioneve Zgjedhore...”, si dhe:

Projektvendimi “Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave...”.

**Znj. D. Alimemeti:** Në lidhje me projektvendimin “Për miratimin e sasisë së fletëve të votimit që do të prodhohen për çdo Qendër Votimi për zgjedhjet e pjeshme për

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 20.07.2024*

Kryetar të Bashkisë Himarë, Qarku Vlorë, të datës 4 gusht 2024”, Presidenti i Republikës, me dekretin nr. 244, datë 05.7.2024, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë Himarë”, caktoi datën 4 Gusht 2024, si ditën e zgjedhjeve, për zgjedhjet e pjesshme për Kryetarin e Bashkisë Himarë. Në mbështetje të nenit 19, pika 1, të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Komisionit Rregullator ose Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve. Duke vlerësuar nga pikëpamja e objekti që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionerit për ta shqyrtuar. Në vijim, në mbështetje të nenit 97, pika 4, të Kodit Zgjedhor, përcaktohet që sasia e fletëve të votimit është e barabartë me numrin e zgjedhësve, duke i shtuar 2 përqind. Në referim të nenit 10, të udhëzimit nr. 1, datë 5.12.2020 të Komisionit Rregullator “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”, përcaktohet afati dhe mënyra e dërgimit të të dhënave për numrin përkatës të zgjedhësve në listën e zgjedhësve për çdo QV. Nga përpunimi i të dhënave të listës përfundimtare të zgjedhësve marrë nga DPGJC në zgjedhjet e datës 04.08.2024, rezulton se në Bashkinë Himarë numri i zgjedhësve është 23.074 zgjedhës, ndërsa numri i qendrave të votimit është 36 QV. Referuar pikës 4, të nenit 97, të Kodit Zgjedhor, sasia e fletëve të votimit që duhet të prodhohet për këto zgjedhje, duke shtuar 2 përqind mbi numrin e zgjedhësve, është njëzet e tre mijë e pesëqind e tridhjetë e pesë fletë votimi. Sa më lart në këtë relacion, Komisioneri brenda kompetencave të tij, në respektim të detyrimeve dhe afateve ligjore të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, i propozohet për shqyrtim dhe miratim ky projektvendim.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 20.07.2024*

**Z. I. Celibashi:** Faleminderit! Dakord! Atëherë, miratojmë projektvendimin në lidhje me sasinë e fletëve të votimit, sipas propozimit të paraqitur.

---

**Vendimi nr. 95**

---

---

---

---

---

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



**RENDI I DITËS**

**Projektvendim: “Për përcaktimin e masës së shpërblimit për operatorët teknikë për përdorimin e kamerës videoregjistruese për zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Himarë, Qarku Vlorë, të datës 4 gusht 2024”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- Stafi KQZ: Znj. M. Koja, znj. D. Alimemeti, z. E. Meta.
- Parti Politike: S’ka prezent!
- Të tjerë: KRIIK

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën e dytë që ka të bëjë me përcaktimin e masës së shpërblimit për operatorët teknikë për përdorimin e kamerës së vëzhgimit në qendrën e votimit.

**Znj. D. Alimemeti:** Vendimi “Për përcaktimin e masës së shpërblimit për operatorët teknikë për përdorimin e kamerës videoregjistruese për zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Himarë, Qarku Vlorë, të datës 4 gusht 2024”. Presidenti i Republikës me Dekretin ...

**Z. I. Celibashi:** Sa është masa e shpërblimit?

**Znj. D. Alimemeti:** Pesë mijë lekë!

Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 20.07.2024*

**Z. I. Celibashi:** Është e njejta masë shpërblimi që është përdorur dhe më parë?

**Znj. D. Alimemeti:** Po është e njejta masë shpërblimi. I referohet zgjedhjeve të datës 14 maj dhe është e njejta masë shpërblimi që mbulohet nga buxheti i miratuar për zgjedhjet e Himarës të datës 4 gusht.

**Z. I. Celibashi:** Dakord! E miratojmë.

**Vendimi nr. 96**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 20.07.2024*

20.07.2024  
Ora 11:10

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim: “Për caktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të Komisioneve Zgjedhore të ZAZ-së nr. 88, në zgjedhjet e pjesëshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Znj. M. Koja, znj. D. Alimemeti, z. E. Meta.
- Parti Politike:** S’ka prezent!
- Të tjerë:** KRIIK

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë, sa është masa e shpërblimit për anëtarët e komisioneve?

**Z. E. Meta:** Përshëndetje, në raport me ngarkesën e punës dhe kohëzgjatjen e aktivitetit të Komisionit të Administrimit Zgjedhor dhe komisioneve të qendrave të votimit dhe grupeve të numërimit të votave, është parashikuar kjo masë shpërblimi:

- Kryetari dhe zv. kryetari i KZAZ-së, në masën pesëdhjetë mijë lekë.
- Sekretari i KZAZ-së, në masën dyzet e shtatë mijë e pesëqind lekë.
- Anëtari i KZAZ-së, në masën tridhjetë e pesë mijë lekë.
- Kryetari i KQV-së, në masën katër mijë lekë.
- Anëtari dhe Sekretari i KQV-së, në masën tre mijë e pesëqind lekë.
- Anëtari i GNV-së, në masën gjashtë mijë lekë.

**Z. I. Celibashi:** Mirë, dakord! E miratojmë dhe këtë projektvendim sipas propozimit të paraqitur.

**Vendimi nr. 97**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim: “Për caktimin e Vendit të Numërimit të Votave të KZAZ-së nr. 88,  
për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

- **Z. Ilirjan Celibashi,** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve
- **Stafi KQZ:** Znj. M. Koja, znj. D. Alimemeti, z. E. Meta.
- Parti Politike:** S’ka prezent!
- Të tjerë:** KRIIK

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë, me caktimin e vendit të numërimit të votave.

**Z. E. Meta:** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor për Kryetarin e Bashkisë Himarë, të datës 4 gusht 2024, i ka adresuar kërkesë Prefektit të Qarkut Himarë, për të vënë në dispozicion të KQZ, listën e plotë të objekteve që përmbushin kriteret e përcaktuara në nenin 93 të Kodit Zgjedhor, me qëllim përzgjedhjen dhe caktimin e Vendit të Numërimit të Votave për ZAZ-në nr. 88. Prefekti i Qarkut Vlorë, me shkresën nr. 691/1 prot., datë 15.07.2024, ka paraqitur objektin i cili mund të shërbejë si Vend i Numërimit të Votave për zgjedhjet e datës 4 gusht 2024. Ambienti i paraqitur është:

- Godina e fushës së Sportit, Rruga “Apelistra”, salla e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, Bashkia Himarë. Prefekti referon se ambienti është në kushte shumë të

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 20.07.2024*

mira. Sipërfaqja i plotëson kriteret e kërkuara dhe duke qenë se ky ambient ka qenë Vend i Numërimit të Votave edhe në zgjedhjet pararendëse, propozohet të miratohet.

---

**Z. I. Celibashi:** Keni bërë ndonjë verifikim për këtë?

**Z. E. Meta:** Po është bërë verifikimi, janë të gjitha kushtet qoftë dhe të kondicionimit.

---

**Z. I. Celibashi:** Dakord! Me këtë vendim, mbyllim të gjitha çështjet që kishim sot në rendin e ditës. Çështje të tjera nuk kemi? Mirë seanca mbyllet, ditë të mbarë!

**Vendimi nr. 98**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

